



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA ELBASAN**

**DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE**

## **SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE**

### **PUNONJËS NË POLICINË BASHKIAKE TË BASHKISË ELBASAN (POLICË)**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015“ Për vetëqeverisjen vendore“, të ligjit nr.8224, datë 15.5.1997“Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake dhe Komunes“(i ndryshuar), neni 11 te Rregullores së brendshme“TIP“ të policisë bashkiake dhe komunes, VKM-së nr.313, datë 1.7.2002,“Për caktimin e struktures ,të numrit te punonësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkise dhe komunes“, (i ndryshuar), Bashkia Elbasan shpall procedurat e konkurimit per vendet e lira :

#### **Policë në Policinë Bashkiake ( 8 policë)**

#### **Kandidatët për policë duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- Te jetë shtetas shqiptar,
- Të ketë kryer arsimin e mesëm /të lartë. Arsimi i lartë përbën avanatazh
- Të jetë i moshës nga 22-30 vjeç,
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar
- Të ketë cilesi të larta morale e qytetare
- Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim te formës së prerë
- Preferohet të ketë punuar në policinë e shtetit dhe të mos ketë qenë i denuar për shkelje të rënda dhe vepra penale

#### **DOKUMENTACIONI ,MËNYRA DHE AFATI I DOREZIMIT**

Kandidatet duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kërkesë për aplikim (me shkrim dore)
- b- Curriculum Vitae
- c- Fotokopje e kartës së identitetit
- d- Çertifikatë e përbërjes familjare

- e- Librezë ushtarake ose vërtetim nga dega e mobilizimit ushtarak
- f- Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar
- g- Çertifikata kualifikimi (në rast se ka)
- h- Fotokopje e librezës së punës
- i- Motivacioni i largimit nga puna e fundit (në rast se është i punësuar ose ka qenë i punësuar
- j- Raport mjeko-ligjor për ushtarakë
- k- Vërtetim i gjendjes gjyqësore
- l-Vërtetim nga prokuroria (që nuk është aktualisht në proces hetimi)
- m- Vërtetim nga Gjykata (që nuk është aktualisht në proces gjyqësor)
- n- 2 Fotografji (një copë 9x6 cm dhe një copë 2.5 x3.5cm)

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo dorazi në Drejtorinë e Administratës dhe Burimeve Njerëzore në Bashkinë Elbasan brenda datës **04.03.2019**

## **REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TE DOKUMENTACIONIT**

Në datë **06.03.2019** ,Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Elbasan do të shpall në faqen e internetit të Bashkisë Elbasan ,në stendat e informimit të publikut dhe në stendat pranë Policisë Bashkiake , listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme , si dhe datën ,vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet testimi . Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankohen pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Elbasan . Afati i ankimimit është **2 ditë** nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

## **FUSHA E NJOHURIVE ,AFTËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me :

- a- Njohuritë mbi ligjin nr. 139/2015”Për vetëqeverisjen vendore”
- b- Njohuritë mbi ligjin nr. 8224, date 15.5.1997 ”Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake dhe Komunës” (I ndryshuar)
- c- Njohuritë mbi Rregulloren e Brendshme “TIP” të policisë së Bashkisë dhe Komunës
- d- Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë

## **MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do te vlerësohen ne lidhje me dokumentacionin e dorëzuar :

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën ,

Kandidatët në intervistën me gojë do të vlerësohen në lidhje me :

- Njohuritë ,aftësitë ,kompetencat në lidhje me punën:
- Eksperiencen e tyre te mëparshme :
- Motivimin ,aspiratat dhe pritshmërite e tyre për karrieren

Kandidatët do të vlerësohen për përgatitje fizike si më poshtë:

1. Kërcim vertikal
2. Ushtrime për barkun 1 minutë
3. Maksimumi i mundshëm pompa
4. Vrap 300 metra
5. Ecje/Kros 1.5 km

Totali i pikëve për vlerësimin e kandidatëve është **100 pikë** i detajuar si me poshte :

Vleresimi maksimal për dokumentacionin është **10 pikë**

Vleresimi maksimal për testimin me shkrim është **50 pikë**

Vleresimi maksimal për intervistën me goje është **10 pikë**

Vleresimi maksimal për përgatitje fizike është **30 pikë**

**Kandidatët që marrin mbi 30 pikë të testimit me shkrim, kanë te drejtë të vazhdojnë fazën e testimit e aftësive fizike dhe intervistës me gojë.**

#### **DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KONKURIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve (testimit me shkrim, intervistës me gojë dhe testimit të aftësive fizike) Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Elbasan do të shpallë fituesit në faqen e internetit të Bashkisë Elbasan, në standat e informimit të publikut dhe në standat e Policisë së Bashkisë. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankohet pranë Njesisë së Burimeve Njerezorë të Bashkisë Elbasan. Afati I ankimimit është **2 ditë** nga data e shpalljes e rezultateve të testimit.